




Empowered lives.
Resilient nations.



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Projektbuxheti 2021:

favorizimet dhe diskriminimet e
komunave në investime kapitale



Dhjetor 2020

Mbështetur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige



*Empowered lives.
Resilient nations.*



Projektbuxheti 2021:

favorizimet dhe diskriminimet e komunave në investime kapitale

Dhjetor 2020

Përmbajtja

3 Përmbledhje ekzekutive

4 Buxheti i ndarë për ministri dhe komuna në projektbuxhetin 2021

6 Investimet kapitale nga ministrinë në komuna

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Institutit GAP dhe jo domosdoshmërisht konsiderohen si qëndrim i UNDP-së apo donatorëve

Mbështetur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige

Përmbledhje ekzekutive

Më 30 tetor 2020 Qeveria e Kosovës ka aprovuar Projektligjin për buxhetin e vitit 2021.¹ Qëllimi i këtij raporti është që të analizojë shpërndarjen e investimeve kapitale të ministrive në komuna në mënyrë që të shihet nëse ka pasur favorizim apo diskriminim për komuna në baza partiake. Investimet kapitale janë burim i rëndësishëm për zhvillim të komunave. Në Projektbuxhet nuk jepen shpjegime për kriteret që aplikohen kur vendoset për investimet e nivelit qendror në komuna.

Sipas Projektbuxhetit për vitin 2021, ministritë do të menaxhojnë rreth 1.54 miliardë euro, prej të cilave 452 milionë apo 29% ndahen për investime kapitale. Nga këto investime kapitale, mbi 93 milionë euro do të investohen në 33 komuna. Kurse komunat, nga gjithsej 550 milionë euro buxhet, rreth 143 milionë euro kanë ndarë për investime kapitale. Investimet kapitale të nivelit qendror në komuna do të jenë më të ulëta krahasuar me ato të vitit 2020.

Tri ministritë me më shumë buxhet të ndarë për investime kapitale në komuna në vitin 2021 do të jenë Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa investimet e Ministrisë së Shëndetësisë në komuna pritet të bien për 92% në krahasim me 2020. Komunat që do të përfitojnë më shumë nga buxheti i ministrive për investimet kapitale gjatë vitit 2021 janë Komuna e Gjakovës, Prishtinës, Deçanit dhe Mitrovicës.

Për shkak se shumica e investimeve kapitale janë vazhdimësi nga vitet e kaluara, qeveria aktuale ka pasur më pak hapësirë për orientim në ndonjë projekt. Rreth 85 milionë euro apo 91% e projekteve që do të investohen nga ministritë në komuna janë vazhdim nga vitet e kaluara, ndërsa rreth 9 milionë euro apo 9% do të jenë investime të reja. Investimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve të reja në komuna. Komunat të cilat do të përfitojnë më shumë nga investimet e reja kapitale në vitin 2021 janë Komuna e Gjakovës, Mitrovicës, Klinës dhe Deçanit.


Sa i përket përqindjes së investimeve krahas popullsisë, komunat e qeverisura nga LDK janë diskriminuar kurse komunat të cilat menaxhohen nga AAK janë favorizuar. Ndërsa, në komunat e qeverisura nga subjektet tjera politike nuk vërehet diskriminim i madh pozitiv apo negativ.

¹ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 38, Burimi: <https://bit.ly/33zsXul>

Buxheti i ndarë për ministri dhe komuna në projektbuxhetin 2021

Në vitin 2021, ministrinë pritet të menaxhojnë rreth 1.54 miliardë euro apo 61% të buxhetit të përgjithshëm të vitit 2021, një rënie prej 10% (167 milionë euro) në krahasim me buxhetin e rishikuar të vitit 2020. Tri ministrinë që do të pësojnë më së shumti ulje të buxhetit janë: Ministria e Financave (42% më pak), Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (40% më pak) dhe Ministria e Shëndetësisë (31% më pak). Ndërsa rritje më të theksuar në buxhet do të ketë Ministria e Infrastrukturës me 32%.


Figura 1. Buxheti i ministrive në vitin 2020 dhe 2021



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Ligjit të Buxhetit të rishikuar 2020 dhe Projektbuxhetit 2021

Rreth 29% të buxhetit të ministrive e përbëjnë shpenzimet kapitale, pjesa tjetër e buxhetit përbëhet nga shpenzimet rrjedhëse, sikurse, subvencionet dhe transferet (46%), paga dhe mëditje (14%), mallra dhe shërbime (9%), shpenzime komunale (0.8%) dhe rezerva (1%).² Krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2020, kategoria e pagave dhe mëditjeve do të kenë rritje mbi 10 milionë euro apo 5%, ndërsa shpenzimet komunale do të rriten me mbi 3 milionë euro apo 36%. Kurse, kategoritë tjera buxhetore kanë pësuar rënie. Në kategorinë subvencione dhe transfere janë ndarë 101 milionë euro më pak apo 12%, mallrat dhe shërbimet parashihen të jenë për 11 milionë euro më të ulëta apo 7% dhe shpenzimet kapitale parashihet të jenë mbi 83 milionë euro më të ulëta apo 16%.³

Figura 2. Shpenzimet rrjedhëse dhe kapitale të ministrive (në miliona euro)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Ligjit të Buxhetit të rishikuar 2020 dhe Projektbuxhetit 2021

Në vitin 2021, buxheti për 38 komunat do të jetë mbi 550 milionë euro apo rreth 31 milionë euro (-5%) më i ulët se në vitin 2020. Komuna me buxhetin më të lartë për vitin 2021 do të jetë Komuna e Prishtinës me rreth 86 milionë euro. Ndërsa, komuna me buxhetin më të ulët do të jetë Komuna e Parteshit me mbi 1 milion euro. Kuvendet komunale të komunave të Prizrenit, Mitrovicës, Kamenicës⁴ dhe Novobërdës nuk e kanë aprovuar buxhetin komunal për 2021. Sipas planifikimeve, në vitin 2021 granti i përgjithshëm, i cili përbën 84% të të hyrave komunale, është për 24 milionë euro (-5%) më i ulët se në vitin 2020, ndërsa të hyrat vetanake që përbëjnë 14% të të hyrave komunale do të ulen për 5 milionë euro (-6%).

Rreth 385 milionë euro apo 70% e buxhetit të komunave në vitin 2021 pritet të ndahen për shpenzimet rrjedhëse dhe rreth 23 milionë euro apo 4% për rezerva. Ndërsa 26% apo 143 milionë euro për shpenzime kapitale. Krahasuar me buxhetin e rishikuar 2020, në vitin 2021 do të kemi ulje të buxhetit në kategorinë e shpenzimeve kapitale të komunave për 13% apo 22 milionë euro. Ulje të buxhetit do të ketë edhe në kategoritë subvencione dhe transfere për 3.5 milionë euro, rezervat për 6.7 milionë euro dhe paga dhe mëditje për 192 mijë euro. Kategoria

² Kuvendi i Kosovës. Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Burimi: bit.ly/36VM5VC

³ Ministria e Financave. Ligji për ndryshim dhe plotësim mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. <https://bit.ly/2WjEAL3>

⁴ Komuna e Kamenicës ka aprovuar buxhetin komunal për vitin 2021-2023 pas leximit të parë të Projektbuxhetit 2021

mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale do të kenë rritje 915 mijë euro dhe 276 mijë euro respektivisht.

Figura 3. Burimet kryesore të financimit të komunave

2020 (buxheti i rishikuar)




2021 (draft - buxhet)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Ligjit të Buxhetit të rishikuar 2020 dhe Projektbuxhetit 2021


Figura 4. Dallimet në shpenzime sipas kategorive ekonomike në komuna



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Ligjit të Buxhetit të rishikuar 2020 dhe Projektbuxhetit 2021

Investimet kapitale nga ministritë në komuna

Investimet kapitale të ministrive në komuna sipas Projektbuxhetit 2021 janë paraparë të jenë mbi 93 milionë euro dhe të shpërndahen në 33 komuna. Buxheti i disa ministrive për investimet kapitale në komuna do të jetë më i ulët krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2020. Si rrjedhojë, është ulur buxheti në total për këto investime. Ministria e Infrastrukturës ka ndarë buxhet për projekte kapitale për rreth 22% më pak se vitin e kaluar, por do të jetë ministria me investimet më të larta në komuna në vitin 2021 me mbi 33 milionë euro, pastaj Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me mbi 23 milionë euro dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me mbi 15 milionë euro investime në komuna. Ulje të theksuar do të ketë në projektet kapitale të Ministrisë së Shëndetësisë ku parashihet të ketë 92% më pak investime në komuna. Komunat që do të përfitojnë më së shumti investime nga ministritë janë Komuna e Gjakovës (12%), Komuna e Prishtinës (10%), Komuna e Deçanit (9%) dhe Komuna e Mitrovicës (8%).

Figura 5. Investimet kapitale të disa ministrive në komuna

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Ligjit të Buxhetit të rishikuar 2020 dhe Projektbuxhetit 2021

Projekti kapital me shumën më të madhe që parashihet të investohet nga ministritë në komuna është mbi 6 milionë euro dhe financohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në Komunën e Gjakovës. Rreth 3 milionë euro pritet të investohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në Komunën e Deçanit; 2.5 milionë euro investime nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Mitrovicës; 2 milionë euro investime nga Ministria e Infrastrukturës në Komunën e Prishtinës; 2 milionë euro investime nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në Komunën e Gjilanit, e të tjera. Përveç projektit kapital në Mitrovicë, projektet e lartpërmendura do të mbulohen nga klauzola e investimeve.

Tabela 1. Disa nga projektet investive me buxhetin më të lartë

Ministria	Projekti	Komuna	Shuma (€)
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	Ndërrimi i gypave të asbestit - çimentos	Gjakovë	6,102,507
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	Kanalizmi fekal në gjashtë fshatra	Deçan	2,675,044
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Renovimi i Stadiumit "Adem Jashari"	Mitrovicë	2,500,000
Ministria e Infrastrukturës	Qarkorja e Prishtinës nga BERZH	Prishtinë	2,000,000
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave te zeza	Gjilan	2,000,000

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Projektbuxhetit 2021

Për shkak se shumica e investimeve kapitale janë vazhdimësi nga vitet e kaluara, qeveria aktuale ka pasur më pak hapësirë për orientim në ndonjë projekt. Rreth 85 milionë euro apo 91% e projekteve që do të investohen nga ministrinë në komuna janë vazhdim nga vitet e kaluara. Ndërsa rreth 9 milionë euro apo 9% do të jenë projekte të reja. Rreth 4.7 milionë euro apo 55% e projekteve të reja do të ndahen nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit nga të cilat 1 milion euro janë planifikuar për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë, 650 mijë euro për ndërtimin e rezervuarit të ujit tek 'Pusi i Atit' në Suharekë, 400 mijë euro për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në Gjakovë, e kështu me radhë. Ndërsa 2.9 milionë euro apo 34% e projekteve të reja do të investohen nga Ministria e Infrastrukturës që do të jenë bashkëfinancim me komuna. Më tutje 7% e projekteve të reja do të investohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 3% nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe 2% nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Figura 6. Investimet kapitale vazhdim/të reja nga ministrinë në komuna



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Projektbuxhetit 2021

Komunat të cilat do të përfitojnë më shumë nga investimet e reja kapitale në vitin 2021 janë Komuna e Gjakovës, Mitrovicës, Klinës dhe Deçanit. Nga rreth 9 milionë euro buxhet për projekte të reja në komuna, rreth 5.1 milionë euro apo 60% do të investohen në komunat e udhëhequra nga AAK; rreth 1.6 milionë euro apo 19% do të investohen në komunat e udhëhequra nga LDK; 1 milion euro apo 12% do të investohen në komunat e udhëhequra nga VV; 725 mijë euro apo 8% do të investohen në komunat e udhëhequra nga PSD; dhe 100 mijë euro apo 1% komunave të udhëhequra nga PDK.


Figura 7. Investimet kapitale të reja nga ministrinë në komuna sipas subjektit politik



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Projektbuxhetit 2021

Gjatë ndarjes së buxhetit nga ministrinë, janë vërejtur dallime në përqindje të popullsisë dhe përqindje të investimeve nëpër komuna. Sa i përket përqindjes së investimeve krahas popullsisë, komunat e qeverisura nga LDK janë diskriminuar kurse komunat të cilat menaxhohen nga AAK janë favorizuar. Ndërsa, në komunat e qeverisura nga subjektet tjera politike nuk vërehet diskriminim i madh pozitiv apo negativ.

Figura 8. Investimet në komuna nga ministrinë për subjektet politike



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Projektbuxhetit 2021, Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal

Komunat e qeverisura nga AAK⁵ (Gjakovë, Deçan, Suharekë, Klinë, Rahovec, Junik dhe Obiliq) përfshijnë rreth 18% të popullsisë dhe zënë rreth 18% të sipërfaqës së Kosovës. Nga 93.4 milionë euro investime kapitale të nivelit qendror në komuna, 34% e tyre do t'i përkasin komunave që menaxhohen nga AAK. Ministria e Infrastrukturës pritet të investojë 30% të projekteve të saj kapitale në këto komuna, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit 59%, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë 35%, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me 18%, Ministria e Punëve të Brendshme 1% dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 100%. Ndërsa, projekti i vetëm për komuna nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të investohet në Komunën e Gjakovës.

Komunat e qeverisura nga LDK (Pejë, Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Podujevë, Istog, Fushë Kosovë dhe Viti)⁶ përfshijnë 28% të popullsisë dhe zënë rreth 29% të sipërfaqës së Kosovës. Nga 93.4 milionë euro investime kapitale të nivelit qendror në komuna, 22% do t'i përkasin komunave që menaxhohen nga LDK. Nëse shohim investimet sipas ministrive në këto komuna, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit planifikon të investojë 35% të projekteve kapitale, Ministria e Infrastrukturës 27%, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit 11%, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë 20% dhe Ministria e Punëve të Brendshme 6%. Ndërsa, projekti i vetëm për komuna nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë parashikohet të investohet në komunën e Vushtrrisë.

Komunat të cilat qeverisen nga PDK (Ferizaj, Drenas, Dragash, Kaçanik dhe Shtime) zënë rreth 11% të sipërfaqes dhe përfshijnë 15% të popullsisë. Nga 93.4 milionë euro investime kapitale të nivelit qendror në komuna, rreth 14% e tyre do t'i përkasin komunave që menaxhohen nga PDK. Ministria e Infrastrukturës planifikohet që të investojë 14% të projekteve të saj kapitale, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit 8%, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë 20%, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit 10%, Ministria e Punëve të Brendshme 26%. Kurse, projekti i vetëm për komuna nga Ministria e Shëndetësisë do të investohet në komunën e Ferizajit.

Komunat e qeverisura nga VV (Prizren dhe Mitrovicë)⁷ zënë 9% të sipërfaqës së Kosovës. Në këto komuna jetojnë 15% e popullsisë. Nga 93.4 milionë euro investime kapitale të nivelit qendror në komuna, 13% e tyre do t'i përkasin komunave që menaxhohen nga VV. Ndërsa, në nivel të ministrive, parashihet që Ministria e Infrastrukturës të investojë 5% të projekteve të saj kapitale, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit 12%, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 12%, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 23% dhe Ministria e Punëve të Brendshme 34% të projekteve të saj kapitale do t'i investojë në këto komuna.

Komunat e qeverisura nga PSD (Prishtinë dhe Kamenicë) zënë 9% të sipërfaqës së Kosovës. Në këto komuna jetojnë 14% e popullsisë. Nga 93.4 milionë euro investime kapitale të nivelit qendror në komuna, 11% e tyre do t'i përkasin komunave që menaxhohen nga PSD. Ndërsa, në nivel të ministrive, parashihet që Ministria e Infrastrukturës të investojë 14% të projekteve të saj kapitale, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit 10%, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë 2%, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 10% dhe Ministria e Punëve të Brendshme 29% të projekteve të saj kapitale do t'i investojë në këto komuna.

5 Komunat që udhëhiqen nga kryetarët e komunave, duke lënë anash shumicën në kuvendet komunale apo koalicionet në ekzekutiv.

6 Interpretimi i te dhënave është bërë para zgjedhjeve të jashtëzakonshme të mbajtura më 29 nëntor 2020 në Podujevë

7 Ibid.

Tabela 2. Investimet e ministrive në komuna

Komuna	Investimet për kokë banori (%)	Sipërfaqja (%)	Popullësia (%)	Subjekti politik	Investimet për kokë banori (në euro)
Junik	15.5%	0.7%	0.4%	AAK	279.64
Deçan	11.3%	2.7%	2.4%	AAK	204.17
Gjakovë	6.8%	5.4%	5.3%	AAK	123.14
Mitrovicë	6.0%	3.0%	3.9%	VV	108.11
Gjilan	4.4%	3.5%	4.3%	LDK	79.67
Klinë	3.9%	2.8%	2.2%	AAK	69.90
Suharekë	3.7%	3.3%	3.2%	AAK	66.09
Ferizaj	3.6%	3.2%	5.9%	PDK	64.71
Drenas	3.3%	2.5%	3.4%	PDK	59.64
Pejë	3.3%	5.5%	5.5%	LDK	58.82
Rahovec	2.7%	2.5%	3.2%	AAK	47.72
Obiliq	2.6%	1.0%	1.0%	AAK	46.79
Prishtinë	2.4%	4.7%	12.2%	PSD	43.49
Kamenicë	2.4%	3.9%	1.6%	PSD	42.73
Mitrovicë Veriore	2.3%	0.1%	0.4%	LS	42.13
Hani i Elezit	2.3%	0.8%	0.6%	I pavarur	41.55
Skënderaj	2.3%	3.4%	2.9%	I pavarur	40.66
Shtërpçë	2.2%	2.3%	0.4%	LS	39.18
Kaçanik	2.0%	0.2%	1.9%	PDK	36.74
Malishevë	1.9%	2.8%	3.1%	NISMA	34.31
Lipjan	1.8%	3.1%	3.2%	LDK	32.88
Istog	1.8%	4.2%	2.3%	LDK	32.54
Novobërdë	1.4%	1.9%	0.7%	LS	24.91
Podujevë	1.4%	5.8%	4.6%	LDK	24.80
Fushë Kosovë	1.4%	0.8%	2.2%	LDK	24.41
Vushtrri	1.3%	3.2%	3.5%	LDK	24.04
Prizren	1.3%	5.5%	10.8%	VV	23.76
Viti	1.2%	2.5%	2.7%	LDK	20.76
Dragash	1.0%	3.9%	1.9%	PDK	17.12
Shtime	0.8%	1.2%	1.5%	PDK	14.80
Zveçan	0.8%	1.1%	0.4%	LS	13.53
Klllokot	0.5%	0.2%	0.2%	Iniciativa Qytetare	9.25
Graçanicë	0.5%	1.2%	0.7%	LS	8.21

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Projektbuxhetit 2021, Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal



*Empowered lives.
Resilient nations.*



Mbështetur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige

Projektbuxheti 2021:
favorizimet dhe diskriminimet e
komunave në investime kapitale